



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.802/22

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkalles se Dytë ne Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses, “...” sh.p.k me seli në Gjilan, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim Faton Qirezi avokat nga Prishtina, kundër të paditurëve 1. me seli në Malta 2. me seli në Serbi, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim Delvina Nallbani avokate nga Prishtina, 3.Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Shëndetësisë dhe 4. Agjensioni Kosovar Për Produkte Medicinale të cilët i përfaqëson i autorizuari me shkrim nga avokatura shtetërore Arsim Zuka nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.Ek.nr.31/2021 e datës 19/03/2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13/10/2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit, “...” sh.p.k me seli në Gjilan, e datës 06.04.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike- III.Ek.nr.31/2021 e datës 19/03/2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin e ankimuar III.Ek.nr.31/2021 e datës 19/03/2021, ka vendosur si vijon:

I.REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “...” sh.p.k me seli në Gjilan e paraqitur kundër të të paditurëve 1. me seli në Serbi , 2.Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Shëndetësisë dhe 3. Agjensioni Kosovar Për Produkte Medicinale me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe fitimin e humbur, me kamatë ligjore prej 3.5 % të llogaritur nga data 19.01.2012 e deri me datën 01.01.2013, si dhe kamatën vjetore prej 8% të

llogaritur nga data 01.01.2013 e deri në pagesën definitive, si dha ka kërkuar që të detyrohet e paditura Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale që t'i tërheq mallrat me afat të skaduar nga stoqet e magazinuara të paditësit dhe t'i shkatërrojë ato sipas procedurës në fuqi.

II.KONSTATOHET se paditësi “...” sh.p.k me seli në Gjilan ka tërhequr padinë ndaj të paditurit të parë me seli në Malta në këtë çështje civile juridike.

III.Shpenzimet e procedurës kontestimore i bartin secila palë veç e veç.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të priset dhe që çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura ka dhënë përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që ankesa e paditëses të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 200 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Paditësi “...” sh.p.k me seli në Gjilan, ka parashtruar padi me datën 26.10.2017, kundër të të paditurve 1. me seli në Malta, 2. me seli në Serbi , 3. Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Shëndetësisë dhe 4. Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale me seli në Prishtinë duke kërkuar kompensimin e dëmit material dhe fitimin e humbur, me kamatë ligjore prej 3.5 % të llogaritur nga data 19.01.2012 e deri me datën 01.01.2013, si dhe kamatën vjetore prej 8% të llogaritur nga data 01.01.2013 e deri në pagesën definitive, si dha ka kërkuar që të detyrohet e paditura Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale që t'i tërheq mallrat me afat të skaduar nga stoqet e magazinuara të paditësit dhe t'i shkatërrojë ato sipas procedurës në fuqi, njëherit ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin III.EK.nr.489/2017, të datës 30.09.2019, kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-

Departamenti Për Cështje Ekonomike, paditësi kishte ushtruar ankesë në bazë të të cilës Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ae.nr.380/2019, dt.17.12.2020, ankesën e paditurës e ka aprovuar ndërsa lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, në procedurën e rigjykimit ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar dhe atë konform dispozitave të nenit 357 paragrafi 3 lidhur me nenin 355 paragrafi 1 të LMD-së.

Paditësja me parashtresën e datës 19.03.2018, e ka tërheqë kërkesëpadinë për të paditurën me seli në Malta, ashtu sipas nenit 261.1, nenit 261.3 dhe nenit 261.4 të LPK-së.

Mbi këto arsye gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 374 par. 1 dhe nenit 376 par. 1 të LMD-së (1978), lidhur me vlerësimin e kërkesëpadisë, si dhe nenin 450 të LPK-së lidhur me shpenzimet procedurale.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë të pathemelta qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2, pika n) të LPK, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e

administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë si dhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale sepse me provat e administruara gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, nga fakti se pretendimet ankimore të paditësit se gjykata nuk e ka saktësuar se nga cili moment ka filluar të rrjedh parashkrimi i kërkesës janë tërësisht të pabazuara duke pasur parasysh se gjykata në shkallë të parë rrjedhën e parashkrimit e ka bazuar në Kontratën Kornizë për 24 muaj, për furnizim me barna dhe material shpenzues Ref: të nënshkruar dhe vulosur nga Ministria e Shëndetësisë dhe me datë 25.02.2011 si dhe shkresa elektronike e datës 19.01.2012 nga Agjensia e Kosovës për Produkte dhe paisje Medicinale, ndërsa paditësi padinë e ka paarqitur me 26.10.2017, andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate lidhur me kohën e afatshme për paraqitjen e kërkesës lidhur me kompensimin e dëmit dhe fitimin e humbur kjo kërkesë është e parashkruar sipas nenit 355 paragrafi 1 i LMD-së, ose sipas nenit 374 paragrafi 1 të LMD-së (1978) e cila parasheh në mënyrë decisive se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”*, në të cilin thirret e paditura se afati i parashkrimit të kërkesëpadisë është 3 vjet. Po ashtu gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar edhe në bazë të nenit 357 paragrafi 1 të LMD-së, ose sipas nenit 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) në të cilin parashihet në mënyrë decisive se *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”*, andaj edhe është përmbush kushti ligjor për refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar duke iu referuar dispozitave të nenit 357 paragrafi 3 lidhur me nenin 355 paragrafi 1 të LMD-së në të cilën është paraparë në mënyrë decisive se *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me cenimin e detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e atij detyrimi”*, si dhe është paraparë se *“kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri vite”*, që nënkupton se paditësja padinë e ka ushtruar pas kalimit të afatit prej 3 vite, andaj mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka zbatuar nenin 374 të LMD-së e cila dispozitë parasheh më sa vijon: Kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e

kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo livrim malli, punë ose shërbim të kryer.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson së gjykata në shkallë të parë me të drejtë i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e paditësit se nuk kemi të bëjmë me parashkrim pasi që paditësi është dëmtuar kur është bërë përmbartimi në lëndën përmbartimore P.nr.566/15 në dobi të paditurës së parë jo më herët se 20.10.2017 kur është nxjerrë urdhri për përfundimin e procedurës përmbartimore, si dhe nga Memo i dt.04.07.2016 nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale të Republikës së Kosovës, me të cilën është njoftuar se janë pezulluar të gjitha certifikatat e autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive serbe, ngase gjykata gjeti se duke u bazuar në nenin 374 paragrafi 1 të LMD-së dhe nenit 376 paragrafi 1 (1978), e që në rastin konkret paditësi ka qenë në dijeni qysh me njoftim e shkresës elektronike AKPPM datës 19.01.2012 e jo me njoftimin/Memo e dytë e lëshuar nga AKPPM me të cilën thirret paditësi e datës të datës 04.07.2016 e as me përmbartimin e lëndës P.nr.566/15.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar kur paditësi ka pretenduar se nëse baza juridike do të konsiderohej marrëdhënie kontraktuese ndërmjet palëve kërkesat nga kontrata nule nuk parashkruhen, mirëpo ka gjetur se pala paditëse me asnjë provë nuk kanë provuar faktin se është duke u zhvilluar procedura ligjore se CPP-at nuk kanë qenë në origjinal apo se këto hetime kanë rezultuar në procedurë penale apo të jetë ngritur ndonjë aktakuzë lidhur me këto raste ,por me provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ka rezultuar se vetëm është pezulluar certifikata e autorizim marketingut për prodhuesit e kompanive Serbe, andaj edhe këtë pretendim gjykata e refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet ankimore lidhur me çështjen se gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat e procedurës kontestimore se ka konstatuar të tërhequr kërkesëpadinë për të paditurën me seli në Malta me aktgjykim, por gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar sepse vendosja me aktgjykim për një veprim procedural nuk përbën shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore andaj gjykata në shkallë të parë ka vepruar duke u bazuar në nenin 261 pika 1 dhe 4 të LPK-së, duke aprovuar propozimin për tërheqje të padisë me aktvendim në procesverbal, e të cilin veprim e ka konstatuar edhe në dispozitiv të aktgjykimit.

Ndërsa lidhur me pretendimin se gjykata në shkallë të parë ka refuzuar propozimin për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare i cili do të përcaktonte përveç lartësisë së dëmit financiar edhe momentin se kur është pësuar ky dëm, gjykata në

shkallë të dytë vlerëson se edhe ky pretendim është i pabazuar për faktin se kur kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës atëherë nxjerrja e provave tjera nuk do të shërbente parimit të ekonomizimit të procedurës kontestimore.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet e paditeses janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga arsyet e cekura Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË

DHOMA E SHKALLES SE DYTË

K.DH.SH.II nr.802/22, me datë 13.10.2022

Gjyqtarja-Kryetare e Kolegjit

Saranda Bogaj-Sheremeti